



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIK E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Pranuar - Pranvjeni	19.01.2023	23	
Nr.i organit Org.broj	Numri i droj	Shtojce Poliq	Vlera Vrednost
01-060/01-49			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershori 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **24.01.2023** (e Martë), në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektit e vjetër të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

### R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2022.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2023.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovin e planeve të punës së komiteteve, komitetit për Shërbime publike, komiteti për Lirit të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, komitetit për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komitetit për Planifikim rregullim të Hapësirave dhe Mbrotjfen e Mjedisit, komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të gjitha planet për vitin 2023

Viti, më 19.01.2023

Me respekt!  
Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA MBLEDHJA E DHJETË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 19.12.2022 (e Hënë) në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 13:00. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkyetar i Komunës), z. Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, znj.Liridona Bislimi, z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama, z.Ilir Zuka. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtoreve, përfasues i OSBE-s. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, nënkyetar, drejtore që jeni prezent në këtë mbledhje, përfasuesi i OSBE-s! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dhjetë të rregullt të KPF-së, takimin e fundit për këtë vitë. Para se të hy në rend të ditës, kisha hap diskutim.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë edhe në mbledhjen e fundit të kuvendit komunal e kam diskutu njëren pikë të rendit të ditës, diskutimin për projektin e Vitisë. Kemi ardhur në një lloj dakordimi në rastë se dojmë me shty për janar si pikë të rendit të dites me diskutu për projektin për Viti, për shkak se është fundi i vitit. Barazimet e të gjitha bëhen në këtë muaj edhe ata e kanë problem.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Unë do t'i ftojë në këtë seancë inxhinierët për pyetjet që po pasohen. I kam thirr edhe ju kam thënë që me qenë aty. Ka shumë pytje në adresë të atyre, edhe çështja e kualitetit, edhe çështja e planit dinamik, të planit të punës, gjithsecili mbikëqyrës i dinë më detalishtë dhe për mos të humbur kohë unë u pata konsultu që, në seancën e ardhshme ka me i sjell inxhinierat dhe këtë praktikë në rastë se ata nuk i pengojë do ta ndejni në çdo seancë. Po mendoj që i shkurton ato diskutimet në logjiken popullore që janë thashetheme.

**z.Jakup Demiri:** Pikërisht që është fundi i vitit janë shumë të angazhum. Mos më i pru për shkak se edhe është viti ri edhe kanë familjar.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Unë e kuptoj këtë që po e thua, se fillova pa përshendetje. Më lejoni të ju përshendes të gjithë të pranishmit që jeni këtu. Unë e kam debatu, kam pas takim me komandantin e policisë në Viti, sot e kam pas edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Gjitha ato të cilët jan shtru nga ana e një anëtarë të kuvendit, që i takon familjes politike të juaj, ashtu siç kam thanë, është ajo është një shtyllë tjetër të cilët nuk e ka obligim, por për shkak të mirëkuptimit, në rast se kryesuesi me mendimin e gjithë këshilltarëve komunal dakordohen që me ardhë me dhanë një informatë, mua nuk më pengon, ma sjellë kryesuesi të nënshkrume që jan dokordu të gjithë këshilltarët e kuvendit komunalë. Unë e shqyrtoj edhe 99% e ka gadishmérinë, personalisht e ka 100%, por në rast se nuk e ka ndonjë pengesë, kjo të jep me kuptu se, të gjitha kërkosat, pavarsisht ju si i merrni, nuk ka që nuk e shqyrtojë në mundësinë që kam me e bërë.

**z.Jakup Demiri:** Kjo puna e policisë për me informu, kjo është e mirë se është edhe fundi i vitit, besoj që kjo ja vlenë, ndoshta për këtë ashtu e kam parë, se inxhinierat janë krejt shërbyses, krejt puntorë, është fundviti, na është dokur që është e bezdissihme për arsyen se mbahet në fundvit.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Parimisht unë mendoj që, pikë të rendit të ditës nuk mundemi me thanë për të

gjitha projektet. Te pjesa e informimit mundemi me caktu një ditë me ardhë inxhinierat me u përgjigj për pyetjet e projekteve.

**z.Ilir Zuka:** Përhendetje për të gjithë të pranishmit! Fillimi i dua që ta nis fjalimin duke u shprehur ngushëllimin gjithëve për vdekjen e Jakup Jahirit, duke e ditë të gjithë për kontributin që e ka dhënë, është një humbje e madhe për Komunën e Vitisë. E kam pritur që ta filloni fjalimin me i shpreh ngushëllime familjarëve dhe të gjithë ata që kanë bashkpunu, por tash besoj që ka ardhë një kohë që njerëzit me kontribute të mëdha shumë shpejt edhe po harrohen. Nënkryeatar, është tu punu një rrugë në Pozheran te korrant. Unë e dij që ajo është në projekt për vitin 2023, por kish fillu me u punu, i kam thirrur edhe inxhinierat, aty duhet me dalë me ndërmarr diçka, sepse jan blloku të gjitha kanallet krejt, ai shi që është ra i ka demtu ato ara. Unë e kam pas një takim me bujqit në Pozheran, kemi dalë e kemi shiku, është në gjendje të mjerueshme. Tek tjetra, ne e dim që te stadiumi "Ibrahim Kurteshi" kanë fillu punimet në 2017 ose në fillim të 2018 dhe jemi kanë shumë të gëzum se në këtë vit është shtruar tepia, por tashtë sipas informacioneve që morra, pata një takim edhe me punëkryersin edhe 3 ditë në rastë se nuk bëhet një pagesë ka me u hek tepia. Në një farë mënyre është kërcnuese. Edhe një problem tjetër, tu e pas parasysh, për fat të mirë Komuna e Vitisë nuk kemi pas vërvshime, por kemi pak problem, Pozherani kemi shumë poseta që janë blloku. Unë kam fol edhe me "Hidromoravë", po dalin po e shikojnë, por nuk po bëjnë zgjidhje. Problemi është tek ato shpia që kanë podrume, janë shumë rezik. Aty duhet me ndërmarr diçka, sidomos te "Lagija Zuka" dhe "Lagija Muhamheri" është pak më rezik.

**znj.Liridona Bislimi:** Përhendetje për të gjithë të pranishmit! I kam dy çështje me i diskutu, por deshta me u lidh edhe me këtë të Ilirit, vetëm deshta me shtu që përpos pajtona që në Pozheran ka problematika të mëdha, besoj që në theks të veçantë janë edhe ato lokalitete ku kanë pasur vërvshime të mëdha viteve të kalume, por që në këtë vit fatbardhësisht kemi shpëtu pak më leht me bë një krahësim me komunat tjera. Këto lokalitete kisha me shti Budriken, fshatin Skifteraj, Remnikun, Radivojcin. Në shumicën e herave tokat bujqesore kanë qenë të domtume zakonishtë shumë. Unë kisha dashtë me bë një pyetje, nëse kisha mujt me pas një informatë te çështja e bursave për studentë. Kisha dashtë me ditë më specifikisht ndonjë datë të caktume, për shkak që studentët e këtij viti janë tu përball me vështirësi të mëdha financiare. Këtë e them edhe në bazë të familjares time. Un i kam dy motra, dhe motra e cila ka qenë më herët i ka përfundu studimet dhe motra që është tashti me të vërtet shpenzimet i ka jashtëzakonishtë shumë të mëdha. Këtu po i shti edhe ndryshimet e çmimeve, inflacionin. Vazhdimesh jam duke pasur pyetje prej studentëve, familjarëve, se kjo ka me qenë një mbështje begi e madhe prej juve, kështu që nëse kisha mujtë me ditë pak a shumë një datë pak më saktë se kur ka me u bë shpërndarja e këtyre bursave. Edhe një gjë tjetër, unë e kam ngritë një shqetësim vazhdimesh në kuvendin komunal përlirim nga pegesa të nxënësve në vendet rurale dhe kam pas një takim me disa nxënës të fshatit Stubell, dhe kam marr lajmin që transporti ka me u pagu prej komunës. Edhe kjo është një përgëzim shumë i mirë, por deshta me ditë a hynë këtu edhe nxenësat e fshatit Dobollde edhe të fshatit Buzovik, për shkak se ka 1 vit prej fshatit Buzovikë që jam duke u taku me familjarë edhe ata janë duke u përball me vështirësi të mëdha, ndërsa nga fshati Dobollde kam pas familjar atje kur ne i kemi marrë fëmijet e tyre i kemi ushqy edhe mbajtë në shpinë tonë vetëm për me perfundu shkollimin. Këtë po e flas prej mandatit të parë që ka qenë problem. Deshta me ditë pasi keni arritë me bë për stubell, a keni mujtë me e bë edhe për këto dy fshatra të tjera.

**z.Hasan Aliu, nënkyrietari i komunës:** Po filloj prej Lagjes së Korranëve, besojë që projekti qenka 2022-2023 dhe tashtë gjatë punimeve ka mujtë me shkaktu telashe. E dijë që një në Sllatinë më është lajmru, e kam lajmru inxhinerin me shku me jek dheun që ja kanë qitë në arë, e këtë informatë nuk e paskam pasë. Tashti ta kemi parasyshë që këto ditë kemi pas edhe reshje të mëdha të shiut, por megjithatë do të bisedoj me inxhinerin mbikëqyrës. Shumë keq po më vjen që një firmë e cila merr shumë tendera dhe me qenë aq naivë mos me ditë kujt të ju drejtohet me pagesë me shku me bë presion te një anëtar i kryesisë së klubit dhe një kryetar i këshillit të fshatit, dhe mos me ardhë në komunë, për mua ajo firmë nuk po dashka as me egzistu, po e them me plotë kuptimin e fjalës. Ai është dashtë të lajmrohet te ne, ta shkojmë pengesën ku është, pse nuk është ekzekutu jo me jekje të tepive, sepse ka nga shumë me marrë për me vendos atë tepij duhet me lypë zgjidhjen për me u bë pagesa. Pranimi teknik në rastë se ka egzistu edhe mu bë pagesa. A formën që e ka zgjedhë ky nuk është formë

institucionale. Unë dij brengen e kryetarit të këshillit fshatit kur e ka paraqitë, që uji po na hynë dhe unë e kam urdhëru që me qit bagerin me ja bërë vijën, mos me hy mos me dëmtu atë punë të madhe, edhe pse nuk është kanë e parapamë. Ti e dinë llir që hyke uji në fushë te lagjja e Muhaxhereve, ky është dashtë me gjetë adresën e saktë do ta shiqojë unë mundësin ta shofë se çka është. Liridona, e dijë që afati është mbyll, konkurrimi është bërë, numrin e saktë nuk e di, edhe ende nuk e kemi formu komisionin për ndarjen. Ta shikojmë njëherë mundësinë se sa studenta i kemi me të vërtet të pranum. Gjithëherë po na shkakton administrata neve telashe se po shkon po i merr dokumentet edhe atij që nuk e ka të regjistrum vitin e rregulltë, edhe tashtë ai po vjen po ankohet që unë i kam qitë dokumentet. Atë selektim është deshtë në radhë të parë me bë aty, mos me na lanë atë barri dhe tani me kqyrë studenta të rregulltë sa i kemi, që me pas mundësi me i përfshi krejtë. E kemi bërë një zgjidhje jo në aspektin ligjor të Stubbles, sepse aspekti ligjor thotë mos me i dhënë, por i kemi subvencionu për me jek, por për këto dy lokalitete nuk kam njouri që i kemi bë zgjidhje, se në aspekt ligjorë e dinë edhe ti edhe unë se të shkollës mesme nuk na obligon me i bajtë, se konsiderohen nxënës të rritur. Te Stublla është çështja më e ndjeshme. E dinë edhe ti, gjithëherë i kem përkdhel në shumë çështje, ndoshta për me i rujtë ato raporte, me të vërtet se si ka ditë Komuna e Vitisë, jo personalisht por Komuna e Vitisë në përgjithësi me i pas raportet e shkëlqyeshme.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Pak te lliri po lidhem, se edhe me mua e shprehi këtë shqetësim. I tregova që ky është dashtë më së pari me bë një kërkesë me ndërpren kontratën, punën, janë disa procedura. Unë nuk e di se si janë, sepse nuk i takojë anës profesionale se si shkonë në procedurë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Tepien te stadiumi.

**z.Ilir Zuka:** Tepien e ka qitë aty, e në momentin që është qit, ajo duhet me u pagu. Nuk dua ta mbrojë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Te Muhaxheret?

**z.Ilir Zuka:** Jo te fusha “Ibrahim Kurteshi”, fusha ndihmse. Ne i kemi 100 probleme me të, por në drejtën ligjore ka të drejtë me e hek me polici e hek, unë po flasë në anë ligjore, se ai nuk guxon me ardhë hiq, ajo çka është qit në Pozheran nuk mundet me u hek.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Ne i kemi pas 3 takime, e kemi lutë me e perfundu me kqyrë mundësinë atë të cilën e ka dhanë Qeveria e Republikës së Kosovës, që mundësia tani e shiqimit të kontratës, ata të cilët kanë pas kontrata 2 vjeçare, atë kurrsesi nuk ka hy në atë. Është kanë ministri i kulturës i cili ka premtu në Viti, që ka thënë para kryetarit filloje punën, përfundoje, se kemi me të kompenzu, nuk e ka dashtë. Në këtë takim kam qenë edhe unë dhe tashti çështjen se a ka bë punë. Unë besojë se inxhinieri mbikëqyrës duhet me dhanë mendimin e tij edhe me ja vertetu fakturen, sepse pa e vërtetu fakturen nuk e bënë pagesën administrata, që është normale. Ajo dhe unë ka me shiqu këtë mundësi pas takimit. Në rast se po, pse mos me ju egzekutu. Në rastë se jo, duhet me thanë shko korigjoje se nuk e ke bë këtë punë.

**z.Ilir Zuka:** Të drejtë ligjore në momentin që nuk ju ka pagu ai vjen me polici. Ai e ka dorëzu fakturën se si më tha, por për qëllime të caktura nuk po egzekutohet.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Te kryetari i klubit shkohet me qu ndonjë donacion me thanë a ki nevojë për përkrahje, nuk shkohet me faktur të komunës, këtë duhet me harru ai.

**z.Jakup Demiri:** Jo që dua me të kundershtu llir, por ai kontratën e ka në komunë, nuk e ka te administratori, e para, dhe e dyta, ai duhet me ju drejtu gjykatës.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Ministri ka thënë, veç ky e ka pas kontratën dhe është dashtë me kry, se e ka pas të nënshkrume kontratën me thanë nuk po du me kry se kanë hyp çmimet, atëherë mbesim krejtë tu e bartë problemin në momentin që e nënshkrue kontratën. Këtu janë bërë disa lëshime, se atij që nuk e krynë në bazë të kontratës ju lëshohet një letër që hynë në listën e zezë edhe ai as nuk mundet me konkuru, mirëpo parimisht nuk janë kanë të përgjegjshem as ata që i ka marrë ato, e fajti ka mbetë që po bartet.

**z.Ilir Zuka:** Kush e ka psu më shumë se ne që e kemi klubin.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Ministri e ka thënë shumë decedivisht, nuk i ka thënë ta renovoj. Unë kam qenë në takim, ka thënë shko ti, puno, bjere fakturen me çmime të reja unë ka me ta pranu, por ky pas ministrit ardhke dhe thojke unë nuk i besoj. Thashë si nuk i beson.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Për këtë takim kemi parapa këtë:

## R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2023.**
3. **Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022.**
4. **Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë.**
5. **Informatë për zbatimin e planit te KKSB-së për vitin 2022.**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përpos këtyre pikave, sot i kemi që na kanë ardhë edhe 2 pika tjera, propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albriht në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022, ka kërku dokumenta shtesë Drejtoria e Kadastrit, Drejtoria e Urbanizmit kanë dergu dokumenta shtesë atëherë, por prapë e kanë kthy që ne duhet ta shfuqizojmë. Edhe pika tjetër që prapë na ka ardhë prej ministrisë, është rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba, që e kemi miratu në kuvend më herët dhe e kemi rishiku prapë në kuvendin e kalum. Tashti është rikthy atë që na e kanë dergu të ligjshme, atë pjesën na e kanë rikthy për një përmisim.

**z.Fatlum Demiri, sekretari i kuvendit:** Kryesues, rregulloren e kam dergu në protokoll, i kam porositë me i protokolu para orës 1, por nuk ma kanë kthyer hala, ndërsa propozimi për shfuqizimin e shperndajta materialin.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** A ka dikush te rendi i ditës me diskutu? Pasi që nuk ka për diskutim: a jeni me ngritje të dorës që të miratohet rendi i dites? Pra, me të gjitha votat pro miratohet rendi i dites.

Si pikë të parë të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** A ka dikush që me debatu në lidhje me procesverbalin? Pasi që nuk ka: a jeni që me ngritje të dorës të miratohet procesverbali. Me të gjitha votat pro miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjate vitit 2023**

**z.Ajet Sallahu, drejtori:** Përrshendetje për të gjithë të pranishmit! Këtë propozim vendim, në bazë të Ligjit 06 L 092 për të Drejtën e Shpronësimit dhe Shkëmbimit të Pronës së Palujtshme Komunale, në këtë rastë të këtij ligji, obligohet komuna që, në fundvit paraprak të bëjnë listën e të gjitha pronave që duhet të jepen për shfrytëzim dhe në këmbim për vitin e ardhshëm në afat optimal në muajin e fundit. Tash e kemi përpilu listën e pronave komunale në shfrytëzim, desitinimi i tyre kryesisht është i karakterit bujqësor, i kemi edhe destinimin për zonën indistriuale si dhe parkingjet. Materialin e keni, nëse keni ndonjë gjë mund të pyetni. Ju lus që këtë pikë të rendit të ditës ta aprovoni, sepse është e domosdoshme për periudhën e ardhshme të vitit të ardhshem, që nëse mendojmë me dhënë prona në shfrytëzim, që mos të kemi pengesa ligjore.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Drejtor, vetëm një pyetje. Ne i kemi pasë gjatë këtij viti 2 prona që veç i kemi formu komisionet për me i dhanë në shfrytzim. Është kanë 18 ari në Smir edhe në Devaj, mos po na del në telashe më vonë, se ne i kemi pasë në procedurë edhe çështjen e parkingeve. Në momentin që kemi hy në vitin kalanderik në vitin 2022, nuk kemi mundur më t'i japim për shkak që kanë thanë nuk i keni për procedurë. Mos po na u përseritet e njëjta, na mbesin edhe e hupin vitin.

**z.Ajet Sallahu, drejtori:** Vendimi është marrë në këtë vit, prandaj kjo për këtë vit këto prona kanë qenë të parapamë për dhënie në shfrytëzim dhe për mos me i dyfishu nuk i kemi kthy ato, por unë do të flasë edhe njëherë me zyrtarët ligjor për ta shiquar a kemi ndonjë pengesë. Nëse jo, atëherë në kuvend e mirtojmë.

**z.Hasan Aliu, nënkyryetari i komunës:** Në ministri i thua i kemi pasë në listë në regjistër 2022, ka vendos kuvendi, ka formu komisionin, janë në procedurë, ka nevojë me i përsërit apo nuk ka.

**z.Ilir Zuka:** Në rast se nuk kalojnë në procedurë, ti nuk ki si me shti më, se nuk janë listat për me dhënë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Unë thashë në bazë të përvojes. Kur kemi hy në vitin 2021 në zgjedhje, ne e kemi pas në procedurë edhe komisionin e formum edhe veç ka pas vlersimi mu bë për shkak të kohës, zgjedhjeve nuk ka pas të drejtë me dhënë në shfrytëzim. Kur kemi themelu kuvendin drejtoresha ka ardhë me propozim për me vazhdu me plasu komisionin sepse ka pas ndryshim dhe nuk kemi mundur që ta hecim procedurën sepse nuk është kanë në listën e dhenjes në shfrytëzim, percjelle këtë nëse ajo nuk është mundemi me plotsu për kuvendë.

**z.Ilir Zuka:** E di këtë problem që e kemi pasë që e ceki kryesuesi edhe e kemi qyrr ne listën që të mos ketë të tjera se nuk munden me hy ka pas rastë që me na ardhë edhe ato që nuk janë në listë nëse nuk është në listë ajo nuk mundet me kalu.

**z.Ajet Sallahu, drejtori:** I kemi shiku dhe jemi mundu që të gjitha pronat që komuna nuk i shfyrzon i kemi shti të gjitha pronat që edhe nëse nuk lëshohen për shfrytëzim ato janë në listë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Me ngritje të dorës: a jeni që kjo pikë të shkojë në kuvend. Nga të gjithë u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**Si pikë e tretë e rendit të ditës:**

### **3. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022**

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Kjo është një informatë e takimeve që kanë ndodhë në kuvendin komunal gjatë tërë vitit dhe komitet funksionale jo obligative që janë e kanë bërë nga një informatë të punës që kanë bërë me takimet që kanë bërë deri tanë dhe të gjitha ju bashkangjiten planit të informates dhe vjen një informatë që me pas edhe një informim edhe me komitetet joobligative, cilat takime, çfarë pika kanë prek, çka kanë rekomandu, cilat janë punët e tyre gjatë tërë vitit që janë bërë. Nëse keni ndonjë pyetje, atëher ata të komitetit do të përgjigjen në kuvend përmë shumë sqarime.

**znj.Liridona Bislimi:** Mëqense nuk i kemi kryesuesit e komiteteve këtu, nëse kemi me bë ndonjë pyetje ose kemi diqka të paqartë, më mirë me lanë në kuvend, sepse aty janë prezantë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Të gjithë të pranishmit janë pro, kunder nuk ka, apstenim nuk ka.

**Si pikë të katër të rendit të ditës:**

### **4. Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë**

**znj.Ibadete Hyseni, zyrtare:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Komuna e Vitisë ka të aprovuar Planin e Integritetit 2020-2022, ku objektivë kryesor i këtij plani është që të rris, rendit përpjekjet dhe punimet për të parandaluar, eleminuar në mënyrë sistematike shkaqet e efekteve shkatrruse, korruptionit dhe të sjellëve jo kritike në komunë. Në tërësi ndoshta nuk keni pas rast planin. Ky plan ka pasë të indetifikuar disa fusha të rezikut, kunder to kanë qenë sistemi i menaxhimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve, menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, inspektimi, gjeodezia, prona, kadastra, shëndetësi dhe mirëqenia sociale, bujqësia, pylltarja dhe zhvillimi rural, shërbimet publike dhe gatishmëria emergjente për të parandaluar senimin e integritetit në këto fusha. Komuna ka marrë një sër masash te manxhimi financiar, hartimi i buxhetit konfrom në kufijë buxhetor nga qarkorja buxhetore nga Ministria e Financave, zbatimi i rregullores për tarifa, ngarkesa, gjoba. Te burimet njerëzore është menaxhuar me sukses procesi i rekrutimit të punëtorëve të rinjë. Është zbatuar rregullorja për procedurat e rekrutimit te web faqja e komunës, ku e kam cek që është hapë një link i veçantë në web faqen zyrtare të komunës. Është pak problem, që 6 muaj faqja nuk funksionon për momentin shkaku i ndryshimit sistemit që është duke u punu. Masat të cilat janë ndërmarr në inspektim, përmirësimi i financimit e të funksionimit është menaxhuar me sukses, është bërë rritja profesionale e stafit sa i përket teknikave të veçanta, janë shtuar inspektimet ad-hok, është realizuar me sukses plani i inspektimit. Masat të cilat janë ndërmarr në gjeodezi, prona dhe kadastër, trajnime adekuate profesionale për stafin e drejtorisë, është siguruar transparencë e plotë në drejtori, duke krijuar

hapësirë për punë, është rritur integriteti në regjistrimin e pronës së paluajtshme si dhe është bërë futja dhe mbajtjen e një sistemi funksional të skanimit dhe arktivizimit profesional. Është menaxhu me sukses regjistrimi dhe çregjistrimi i hipotekave në raport me bankat dhe noterin. Masat të cilat jan ndërmarr në shëndetësi, është bërë koordinimi me sektorin e buxhetit sa i përket planifikimit buxhetit për nevojat e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, janë rritur fondet për shëndetësi, është rritur stafi shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, është përmirësuar infrastruktura në objektet shëndetësore, është zbatu rregullorja për ndarjen e subvacioneve nga Drejtoria e Shëndetësisë. Masat në bujqësi të cilat jan ndërmarr, është bërë përcaktimi i sektorëve që duhet tu ju jepen subvencionet, ku subvencionet më të mëdha janë bërë në sektorin e bujqësisë, është menaxhuar me sukses transparenca, efektiviteti dhe efikasiteti në ndarjen e subvacioneve, stafi i drejtorisë është trajnuar në mënyarë adekuate për ndarjen e subvacioneve. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike janë marrë një sër masash, masat e fundit që janë ndërmarr në komunikim me akteret e jashtëm janë zhvillimi i masav për të komunikuar me akterët e jashtëm, janë mbajt 14 dëgjime buxhetore përmes fushatave sensibilizuese, shpërndarjes, është bërë vtdijësimi i qytetarëve për të drejtat e përgjegjësitë e tyre, është bërë fuqizimi i zbatimit, mekanizmat e krijuar për dorëzimin e ankesave dhe kërkesat e qytetarëve, ku qytetarët kanë mundësi që ankesat e tyre t'i kërkojnë edhe në web faqen zyrtare të komunës. Në këtë vit i skadon afati i këtij plani, tash e kemi hartu planin e draftit final që jemi tu e përgatit aty. Janë caktu fusha të tjera të rrezikut përmes plotësimit të pyetësorëve nga përgjegjësat e sektorëve. Përveç këtyre fushave janë caktuar edhe fushatat e tjera për këtë vit. Kjo ishte.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** A ka dikush që të diskuton për këtë pikë të rendit të ditës? Pasi që nuk ka për diskutim, a jeni që kjo pikë të shkojë në kuvend. Të gjithë të pranishmit janë pro, kunder nuk ka, apstenim nuk ka.

Si pikë të pestë të rendit të dites kemi:

## 5. Informatë për zbatimin e planit te KKSB-së për vitin 2022

**znj.Ibadete Hyseni, zyrtare:** Si çdo fundvit, edhe këtë fundvit po raportojmë për zbatimin e planit për KKSB-në. Ky këshill realizon një sër aktivitetesh, duke u nis nga mbajtja e takimeve periodike, ku në vitin 2022 janë mbajtur 6 takime. Përveç raportimit të rregullut të gjendjes së drejtorisë në komunë nga ana e policisë dhe forumeve tjera të sigurisë janë shtjelluar edhe tema të ndryshme rreth çështjes së sigurisë publike në lokalitete të ndryshme të Komunës së Vitis, është rregulluar sinjalistika horizontale dhe vertikale në komunikacion, është bërë rregullimi trotuareve në zona të ndryshme të komunës, ndriçimi publik. Policia me sukses ka realizuar planet operacionale ku janë realizuar një sër aktivitetesh si dhe mosmbajtja e ligjeratave nëpër shkolla me tema të ndryshme, si: parandalimi, trafikimi me njerëz, parandalimi i dhunës, lajmet e rreme, parandalimi i përdorimi të narkotikëve, keqpërdorimi i rrjeteve sociale, krimet kibernetike, ku këto aktivitete janë mbështetur edhe nga Qendra për Punë Sociale, psikolog shkollor dhe gazetarë lokal. Janë formuar ekipet e nxënësve për sigurinë nëpër shkolla. Materialin e keni marrë me kohë, për të gjitha pyetjet shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**znej.Liridona Bislimi:** Te faqja e fundit që është, Zyra për Riatdhesim, unë kam pas mbajtur një trajnim në muajin Gusht edhe kemi qenë përfaqësues të të gjitha komunave, ka qenë organizatë e jashtit. Ndër temat e diskutimit kemi diskutu edhe për këtë temë, edhe Komuna e Vitisë ka qenë në mesin e atyre pak komunave në zonën e kuqe ku ka pas persona të riatdhesuar, por me theks të veçantë tema e diskutimit ka qenë edhe për ata personat të cilët një kohë kanë pas fluksin e madh në migrim për Siri dhe janë riatdhesu. Tema e diskutimit që e kemi mbajtë, se komunat nuk kanë qenë shumë aktive në këtë pjesë, për shkak se ka qenë një temë jo e freskët, jo e njohur për ne dhe ne kemi pasë rastin në fshatin Debëllde, ku kemi pas një numër të banorëve që kanë pas atë kampin e tyre. Unë nuk është që kam pasë shumë informacione, por kjo është një temë tabu edhe në shoqni që nuk është diskutu edhe shumë. Ndoshta kemi pas raste edhe në familjet tonë, informacione që kemi ditë ose ngjarje, por nuk është që i kemi diskutu në mesin e shoqerisë për shkak se ka qenë një temë tabu e panjohur. Po më intereson me ditë kjo zyre sa ka pasë aktivitet, a ka qenë shumë aktive, sa ka pasur persona të cilët kanë ardhur në këtë zyre e i keni ofru ndihmë, se po e përsëris prapë që, komuna jonë, sidomos në pjesën e asaj shoqërisë, te pjesa që kanë migru për Siri dhe janë kthy, e kemi një numër të caktum edhe është një temë shumë e ndjeshme dhe te kjo e fundit 25 Nëntor a është moto “asnje më shumë”, a mos është motoja “as edhe një më shumë”, mos ka qenë motoja ndryshe.

**znj.Ibadete Hyseni, zyrtare:** Motoja është e njejt prej ministrisë ka ardhë.

**z.Hasan Aliu, nënkyetari i komunës:** Po të ndihmojë, se e ka prek edhe një temë të cilën Ibadeti nuk e ka shtjelli, ktu e ka shti zyrja e cila punon për personat të riatdhesum, por jo ata të cilët i përmende ti, ata nuk hinë në këtë listë.

Si pikë të gjashtë të rendit të dites kemi:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit Madelein Albriht, në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022**

**z.Ilir Zuka:** Kryesues, a e keni një numër të saktë se sa i kemi shfuqizu në këtë vit.

**z.Fatlum Demiri, Sekretari i Kuvendit:** Po janë 3 ose 4, mundesh me ardhë në zyrë dhe me ta dhanë numrin e saktë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Ne kemi që na e kanë kthy jo të ligjshme, sikur rregullorja që na u kthehet. Ky është plotësim ndryshim, vendim që e shfuqizojmë është te varrezat në Kabash, është e përmendores edhe ky i treti, këto janë vendime që shfuqizohen, që janë jo në harmoni me planin urbanistik zhvillimor, ndërsa tjera, janë rregullore, nuk është përputh një nen në bazë të ligjit. A jeni me ngritje dore që kjo pikë të shkojë në kuvend. Me të gjitha votat shkon në kuvend.

Si pikë të shtatë të rendit të dites kemi:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba**

**z.Fatlum Demiri, sekretari i Kuvendit:** Faleminderit shumë! Ne në muajin Shtator kemi miratu Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba, e kemi dergu në MAPL për konfirmim të ligjshmërisë, MAPL ka dhanë vërejtje, vrejtjet që ka dhënë MAPL i kemi inkorporu në ndryshim, i kam dërgu ndryshim plotësimin e rregullores tek tash kush e ka shqyrtu në Ministri të Planifikimit Hapësinor për herë të dytë, nuk e di, por ata kanë thanë që duhet me u fut edhe Udhëzimi Administrativ 05 për 2021, për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 09/2020. Heren e parë kanë thanë që, rregullorja është konformë Udhëzimit Administrativ 09/2020, na kanë thanë është në rregull, për herë të dytë po thonë duhet me u inkorporu edhe ndryshim plotësimi i udhëzimit. Unë kam kontaktu sot me ministrin, por fundi është që duhet me qit edhe një here në kuvend.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më për debat, a jeni që kjo rregullore të shkojë në kuvend me ngritje të dorës. Nga të gjithë të pranishmit miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës,  
Faleminderit shumë që ishit pjesë e kësaj mbledhje, shihemi në mbledhjet e tjera!

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

---

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE : OPŠTINA VITINA

Pranum - Prizreni Maqedonija 18-01-2023

Nr.i organit Org.broj	Numri/Broj	Shtetësia Prilog	Vlera Vrednost
	09-602	0-68	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA

## Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2022

Viti 18.01.2023



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA**



**DREJTORIA E FINANCAVE**

Data/Datum/Date	18.01.2023
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From	Z. Besnik Imeri, Drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-dhjetor 2022

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sone buxhetore (657) për periudhen janar-dhjetor 2022 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

### Të hyrat

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022 janë inkasuar gjithesej të hyra vetanake në vlerë prej 1.183.367,92€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 119,79%, ndërsa Krahasuar me të hyrat për periudhën janar – dhjetor te vitit 2021 te hyrat e vitit 2022 janë me te larta per 29.496,94€

### Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhen janar – dhjetor te vitit 2022 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 14.348.524,18€, ndersa shpenzimet janë: 14.093.852,45€ , shkalla e ekzekutimit te buxhetit per periudhen janar- dhjetor 2022 eshte 98,23% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategorit ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do ti paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve te financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

**Buxheti i Aprovuar,Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-dhjetor 2022**

Aprovim		Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet&huamarria	Totali i Aprovimeve
1	Pagat &Shtesat	7,858,954.01	0.00	0.00	90,747.92	7,949,701.93
2	Mall.&Sherbime	1,945,704.00	147,000.00	176,024.21	425.70	2,269,153.91
3	Komunali	320,000.00	0.00	0.00	0.00	320,000.00
4	Subvencione	0.00	360,000.00	162,048.68	46,202.81	568,251.49
5	Kapitale	2,197,618.00	480,868.00	344,776.79	219,136.96	3,242,399.75
		12,322,276.01	987,868.00	682,849.68	356,513.39	14,349,507.08

Alokimet		Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet 22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	7,857,971.11	0.00	0.00	90,747.92	7,948,719.03
2	Mall.&Sherbime	1,945,704.00	147,000.00	176,024.21	425.70	2,269,153.91
3	Komunali	320,000.00	0.00	0.00	0.00	320,000.00
4	Subvencione	0.00	360,000.00	162,048.68	46,202.81	568,251.49
5	Kapitale	2,197,618.00	480,868.00	344,776.79	219,136.96	3,242,399.75
		12,321,293.11	987,868.00	682,849.68	356,513.39	14,348,524.18

Te paalokuara		Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet 22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve
1	Pagat &Shtesat	982.90	0.00	0.00	0.00	982.90
2	Mall.&Sherbime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
		982.90	0.00	0.00	0.00	982.90

Shpenzimet		Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	% shpenzimit
1	Pagat &Shtesat	7,848,295.93	0.00	0.00	89,866.02	7,938,161.95	99.87%
2	Mall.&Sherbime	1,923,605.72	137,272.66	170,143.45	0.00	2,231,021.83	98.32%
3	Komunali	271,624.84	0.00	0.00	0.00	271,624.84	84.88%
4	Subvencione	0.00	288,922.27	138,638.68	31,152.50	458,713.45	80.72%
5	Kapitale	2,195,491.45	445,132.83	334,586.45	219,119.65	3,194,330.38	98.52%
		12,239,017.94	871,327.76	643,368.58	340,138.17	14,093,852.45	98.23%

Diferencia Alokim-Shpenzim		Alokimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	9,675.18	0.00	0.00	881.90	10,557.08
2	Mall.&Sherbime	22,098.28	9,727.34	5,880.76	425.70	38,132.08
3	Komunali	48,375.16	0.00	0.00	0.00	48,375.16
4	Subvencione	0.00	71,077.73	23,410.00	15,050.31	109,538.04
5	Kapitale	2,126.55	35,735.17	10,190.34	17.31	48,069.37
		82,275.17	116,540.24	39,481.10	16,375.22	254,671.73

Diferencia Aprovim-Shpenzim		Aprovime 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve
1	Pagat &Shtesat	10,658.08	0.00	0.00	881.90	11,539.98
2	Mall.&Sherbime	22,098.28	9,727.34	5,880.76	425.70	38,132.08
3	Komunali	48,375.16	0.00	0.00	0.00	48,375.16
4	Subvencione	0.00	71,077.73	23,410.00	15,050.31	109,538.04
5	Kapitale	2,126.55	35,735.17	10,190.34	17.31	48,069.37
		83,258.07	116,540.24	39,481.10	16,375.22	255,654.63

**Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore**

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	7,949,701.93	7,948,719.03	7,938,161.95	11,539.98	10,557.08	99.87%
2	Malta dñe sherbime	2,269,153.91	2,269,153.91	2,231,021.83	38,132.08	38,132.08	98.32%
3	Subvencione	568,251.49	568,251.49	458,713.45	109,538.04	109,538.04	80.72%
4	Komunali	320,000.00	320,000.00	271,624.84	48,375.16	48,375.16	84.88%
5	Shpenzime kapitale	3,242,399.75	3,242,399.75	3,194,330.38	48,069.37	48,069.37	98.52%
	<b>Gjithesejt</b>	<b>14,349,507.08 €</b>	<b>14,348,524.16 €</b>	<b>14,093,852.45 €</b>	<b>255,654.63 €</b>	<b>254,671.73 €</b>	<b>98.23%</b>

**Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore**

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	6,156,080.82
11500	Talimi në paga	357,885.51
11600	Kontributi i punëtorit	343,767.13
11700	Kontibutit i punëdhënsit	343,767.13
11115	Sindikata	23,263.93
11125	OLK	2,533.68
11126	OMK	1,920.00
11900	Pagesa per vendime gjygesore	708,943.75
	<b>Totali i pagave</b>	<b>7,938,161.95</b>
13130	Shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit	14,344.92
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	8,553.40
13141	Meditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	528.00
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit	3,910.00
13210	Shpenzimet e rrymës	181,079.13
13220	Shpenzimet e ujit	24,761.23
13230	Shpenzimet e mbeturinave	26,138.75
13250	Shpenzimet e telefonis fiksë	9,110.20
13260	Pagesa - vendime gjygesore	30,535.53
13310	Shpenzimet per internet	3,978.70
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	14,524.78
13330	Shpenzimet postare	6,659.15
13340	Shpenzimet e perdominit te kablilit optik	400.00
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	344,460.90
13440	Sherbime te teknike	2,326.30
13450	Sherbime shypje - jo marketing	20,728.42
13460	Sherbime Kontraktuese tjera	277,315.07
13470	Sherbime teknike	5,428.20

13480	Shpenzimet per anetaresim	8,548.05
13501	Mobilje	65,455.00
13503	Kompjuter	38,803.00
13508	Paisje Trafiku	38,136.64
13509	Paisje lëra	292,120.13
13610	Furnizime për zyre	76,620.05
13611	Furnizime me dokumenta bilanko	3,050.00
13620	Furnizimi me ushqim dhe pjetë dreka zyrave)	20,767.59
13630	Furnizime mjekesore	80,324.81
13640	Furnizime pastrimi	6,752.26
13650	Furnizimi me veshembathje	4,410.00
13720	Nafte per ngrohje gendore	23,366.27
13760	Funizim me lende dëgëse (dru)	225,571.25
13770	Derivate per gjenerator	4,371.54
13780	Derivate veturave	64,214.30
13950	Regjistrimi i automjeteve	4,134.90
13951	Sigurimi i automjeteve	7,205.48
14010	Mirembatja dhe ripari i automjeteve	38,417.00
14020	Mirembatja e ndertesave	245,466.72
14023	Mirembatja e shkollave	1,558.10
14032	Mirembatja e autotregjeve lokale	150,323.76
14040	Mirembatja e teknologjis informative	6,511.20
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve	18,827.50
14060	Mirembatja rutinore	38,330.00
14150	Qirata per perdorime lëra hapsiore	385.00
14220	Bolimet e publikimeve	7,660.00
14230	Shpenzimet per informim publik	3,005.51
14310	Dreka zyrare	35,912.03
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	19,615.90
<b>Totali për shërbimeve malta dne</b>		<b>2,502,646.67</b>
200	Subvencionet dhe transfere	428,167.20
22300	Pagesa vendime gjykesore	30,546.25
<b>Totali i subvencioneve</b>		<b>458,713.45</b>
300	Inveslime kapitale	3,194,330.38
<b>Tatali i investimeve kapitale</b>		<b>3,194,330.38</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>14,093,852.45 €</b>

**Kodi 16033**

**Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit**

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet pa shpenzuar	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	259,907.32	259,907.32	259,907.32	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	118,868.97	118,868.97	115,593.28	3,275.69	3,275.69	97.24%
3	Subvencione	155,788.62	155,788.62	132,358.20	23,430.42	23,430.42	84.96%
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	<b>Gjithsej</b>	<b>534,564.91 €</b>	<b>534,564.91 €</b>	<b>507,858.80 €</b>	<b>26,706.11 €</b>	<b>26,706.11 €</b>	<b>95.00%</b>
<b>Shpenzimet e Zyres Kryetarit 16033</b>							
Kodi	Përshkrimi	Shuma					
11110	Paga neto	220,677.13					
11500	Tatimi në paga	14,271.35					
11600	Kontributi i punëtorit	12,339.71					
11700	Kontributi i punëdhënësit	12,339.71					
11115	Sindikata	279.42					
	<b>Totali i pagave</b>	<b>259,907.32</b>					
13140	Shpenzimet e udhezimit zyrtar ja shëtie vendit	400.85					
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe keshillëdhënese	94.40					
13450	Shërbime shtypje - jo marketing	6,147.32					
13460	Shërbime kontraktuese tjera	69,113.22					
13480	Shpenzimet per anetaresim	8,548.05					
13503	Kompiuter	2,546.00					
13509	Pajisje tjera	6,933.41					
13610	Furnizime per zyre	1,900.60					
13620	Furnizime me ushqim dhe pijë (jo dreka zytare)	1,186.65					
13780	Karburant per vetura	1,170.57					
13950	Registrimi i automjeteve	20.00					
14010	Mirembalja dhe rparimi i automjeteve	1,228.00					
